



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKË SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 18/04/2019

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “**Electrical Power Engineering**” sh.p.k, me NUIS K81511012V dhe me adresë: rruga "Teodor Ruzvelt", Pallati Nelsi, Kati I, Lagjja Selitë, Farkë, Tiranë.

Procedura e prokurimit: E hapur.

Numri i referencës së procedurës: REF-12776-03-07-2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Materiale për ndriçim” afati: 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 10, Date 11.03.2019.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Shoqëria “**Electrical Power Engineering**” sh.p.k ,me NUIS K81511012V dhe me vlerë 21.766.000 (njëzetë e një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.
2. Shoqëria “**HEST**” sh.p.k, me NUIS L21527009H dhe me vlerë 21.800.500 (njëzetë e një milion e tetëqind mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “**HEST**” sh.p.k, me NUIS L21527009H.
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - a) Nuk përmbush Kriteret e përgjithshme të pranimit / kualifikimit ku thuhet se “*...Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.*” pasi OE nuk ka paraqitur shtojcën 8.
 - b) Nuk përmbush pikën 1/b dhe c të Kritereve të veçanta të kualifikimit, ku thuhet se “ 1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:...b.Deklaratë mbi përmbushjen e

specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;c.Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;... ” pasi OE nuk ka paraqitur këto dy deklarata.

- c) Nuk përmbush pikën 2.2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar ku thuhet se " *Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2016, 2017,2018) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit përkatësisht: **9.841.000** (nëntë milion e tetëqind e dyzetë e një mijë) lekë pa TVSH.*"pasi OE nuk ka paraqitur dokument për këtë pikë.
- d) Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku thuhet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori për mallrat, objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij*"pasi autorizimi i paraqitur në gjuhë të huaj është i pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, në kundërshtim me kriteret e përgjithshme të pranimit / kualifikimit ku thuhet se "*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe*".
- e) Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku thuhet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/skeda teknike për të gjithë mallrat, objekt prokurimi ku të jepen të gjitha karakteristikat teknike të tyre, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.*"pasi OE nuk ka paraqitur katalogë/skeda teknike për mallrat, objekt prokurimi.
- f) Nuk përmbush pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik ku thuhet se "*Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e materialeve të pasqyruara në tabelën e mëposhtme pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit në datën dhe orën e hapjes së ofertave. **Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s'kualifikim...**"pasi OE nuk u paraqit me mostra sipas kërkesës së mësipërme.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “Electrical Power Engineering” sh.p.k, me NUIS K81511012V** dhe me adresë: Rruga “Teodor Ruzvelt”, Pallati Nelsi, Kati I, Lagjia Selitë, Farkë, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **21.766.000 (njëzetë e një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga 5 Maji**, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 10.04.2019.

Ankesa: Nuk ka.